LIGJ
Nr.10 164, datë 15.10.2009

PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar, me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Autoriteti" është Autoriteti Rrugor Shqiptar, i krijuar sipas dispozitave të këtij ligji;

b) "Ministri" është ministri përgjegjës për çështjet e transportit rrugor;

c) "Rrugët shtetërore" janë rrugët e klasifikuara në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor;

ç) "Kodi Rrugor" është ligji nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

d) "DPRR" është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve;

dh) "Rregullorja e DPRR-së" janë rregullat e vendosura nga ministria përgjegjëse, në përputhje me nenin 13 të Kodit Rrugor, e cila rishihet çdo dy vjet;

e) "PKT" është Plani Kombëtar i Transportit;

ë) "IT" është Instituti i Transportit, i ngarkuar me detyrat e mirëmbajtjes dhe të përditësimit të PKT-së;

f) "Marrëveshja e shërbimit" është marrëveshja ndërmjet ministrit dhe Autoritetit, ku përcaktohen marrëdhënia ndërmjet palëve dhe funksionet, duke specifikuar detyrimet për fondet, planifikimin, mbarëvajtjen dhe raportimin;

g) "Bordi" është bordi i menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar;

gj) "SD" është PKT-ja dhe strategjia sektoriale e transportit, si dhe çdo dokument tjetër, që mund të hyjë në veprim, në lidhje me transportin rrugor;

h) "Menaxhim i rrjetit rrugor shtetëror" është programimi, planifikimi, financimi dhe mbikëqyrja në fushën e projektimit, të ndërtimit, të mirëmbajtjes dhe të rehabilitimit të rrugëve shtetërore.

Neni 3
Krijimi dhe statusi i Autoritetit

1. Autoriteti është person juridik, publik, i cili organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të statutit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të legjislacionit në fuqi.

2. Autoriteti ka selinë qendrore në Tiranë dhe drejtori rajonale në qarqe.

3. Mënyra e organizimit dhe struktura e Autoritetit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është menaxhimi i rrjetit rrugor shtetëror, në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor dhe të këtij ligji.

Neni 5
Funksionet e Autoritetit

1. Autoriteti ka këto funksione:
a) përmbushjen e detyrimeve, sipas Kodit Rrugor;
b) krijon qendrat e menaxhimit elektronik të trafikut dhe miraton statusin e tyre;
c) garanton siguri për të gjithë përdoruesit e rrugës në të gjitha veprimtaritë që organizon;
ç) krijon dhe mirëmban sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave;
d) asiston në përditësimet vjetore dhe rishikimet pesëvjeçare të PKT-së për sektorin e transportit rrugor, në bashkëpunim me Institutin e Transportit;
dh) mirëmban dhe zbaton Manualin Shqiptar të Ndërtimit të Rrugëve dhe Specifikimet Teknike;
e) merr nisma për studime, kërkime shkencore dhe eksperimente për efiçencën, trafikun, qarkullimin dhe sigurinë rrugore;
ë) përgatit programe afatmesme zhvillimi dhe programin vjetor të punës për ndërtimin, rikonstruksionin, mirëmbajtjen, ruajtjen, dhe zhvillimin e rrugëve shtetërore, në përputhje me përparësitë e përcaktuara në dokumentet strategjike.
2. Autoriteti përgatit një raport vjetor për ministrinë përgjegjëse dhe Këshillin e Ministrave, ku pasqyron veprimtarinë e kryer dhe planin në vazhdim. Raporti publikohet në internet.
3. Autoriteti mban librat kontabël, harton e publikon të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar, në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
4. Autoriteti raporton te ministri përgjegjës për veprimtarinë e realizuar, në përputhje me këtë ligj.

Neni 6
Ministri

1. Në përputhje me standardet, ministri mund të marrë nismën për kalimin e një pjese të rrugëve me ent pronar shtetin apo entet e tjera pronare, sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor, kur gjykon se funksionimi i tyre mund të kryhet më mirë nga Autoriteti sesa prej entit përkatës.
2. Ministri, në zbatim të politikave dhe përparësive të përcaktuara, lidh marrëveshje shërbimi me Autoritetin, ku përcaktohen kompetencat, të drejtat e detyrimet, nivelet e mbështetjes, përgjegjësitë dhe raportimi, si dhe treguesit kryesorë të performancës së shërbimit të kryer.

Neni 7
Organet e Autoritetit

Organet e Autoritetit janë:
1) Bordi;
2) Drejtori i përgjithshëm.

Neni 8
Bordi i menaxhimit

1. Bordi është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së Autoritetit.

2. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e institucioneve përkatëse.

Përbërja e bordit është si më poshtë:

a) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për transportin rrugor;

b) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;

c) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për pronën shtetërore;

ç) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor;

d) 1 përfaqësues nga shoqata e kontraktorëve;

dh) 1 përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;

e) 1 përfaqësues nga Shoqata e Inxhinierëve Konsulentë.

3. Mbledhja e bordit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

4. Bordi merr vendimet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

5. Në rast largimi të anëtarëve të bordit, zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me pikat 2 dhe 7 të këtij neni.

6. Pagesa e anëtarëve dhe kryetarit të bordit, e drejtorit të përgjithshëm dhe e punonjësve të autoritetit, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Anëtarët e Bordit emërohen për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

8. Bordi, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh zëvendëskryetarin. Kryetari është përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për transportin rrugor.

Neni 9
Kriteret dhe kushtet për t'u zgjedhur anëtar i bordit

1. Anëtarët e bordit duhet të jenë personat me përvojë në lidhje me rrugët, transportin, çështjet industriale, tregtare, financiare, juridike apo mjedisore.

2. Anëtari i bordit duhet të plotësojë këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar dhe të banojë në Republikën e Shqipërisë;

b) të këtë arsimin e lartë dhe përvojën, sipas pikës 1 të këtij neni;

c) të mos jetë i dënuar penalisht;

ç) të mos jetë shkarkuar nga detyra apo të mos ketë marrë masa disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës;

d) të mos ketë konflikt interesash me detyrën.

Neni 10
Largimi nga detyra

Anëtari i bordit lirohet nga detyra, me vendim të organit që e ka emëruar, kur:

a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një krimi;

b) bëhet i paaftë për të kryer detyrën për shkak sëmundjeje;

c) mungon brenda një viti në më shumë se në 1/3 e mbledhjeve të Bordit;

ç) vërtetohet se nuk përmbush më detyrimet e shkronjës "d" të nenit 9 të këtij ligji;

e) në mënyrë të përsëritur, mbi dy herë radhazi, pengon formimin e kuorumit të nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes së bordit.

Neni 11

Detyrat dhe të drejtat e bordit

Bordi është organi i vetëm përgjegjës për:

a) përcaktimin e politikave të biznesit të Autoritetit;.

b) vendimet, që rregullojnë veprimtarinë e Autoritetit;

c) miratimin e rregullores së brendshme të Autoritetit;

ç) miratimin e programeve të brendshme vjetore dhe të buxhetit korrespondues të Autoritetit.

Neni 12

Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm

1. Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm janë:

a) siguron drejtimin dhe administrimin efektiv të Autoritetit;

b) zhvillon, zbaton e realizon veprimtaritë e përcaktuara nga ky ligj;

c) përgatit dokumentacionin e Autoritetit për burimet njerëzore dhe i administron këto burime dhe kualifikimin e tyre;

ç) përfaqëson Autoritetin në ministrinë përkatëse dhe në marrëdhënie me të tretë;

d) siguron zbatimin e politikave të Autoritetit dhe të kërkesave të tjera ligjore për këtë Autoritet;

dh) siguron të dhëna për bordin drejtues për çështjet, që lidhen me Autoritetin;

e) bashkëpunon në hartimin e politikave, që synojnë përmirësimin e veprimtarisë së Autoritetit dhe vë në dijeni bordin për këto politika;

ë) zbaton detyra të tjera, të caktuara nga bordi;

f) emëron nëpunësit dhe personelin e nevojshëm të Autoritetit, të përzgjedhur nga një tërësi kandidatësh të kualifikuar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kodin e Punës;

g) merr pjesë në mbledhjet e bordit pa të drejtë vote.

2. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga Kryeministri me propozimin e ministrit dhe nuk është anëtar i bordit. Drejtori i përgjithshëm është menaxheri i përgjithshëm i Autoritetit dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga bordi, duke i raportuar drejtpërdrejt atij.

3. Drejtori i përgjithshëm emëron drejtorët e drejtorive rajonale në qarqe.

4. Drejtori i përgjithshëm zbaton politika për forcimin e Autoritetit dhe të përgjegjësive, informon stafin për nivelin e punës së tyre dhe kryen detyrat publike, duke ruajtur mirëbesimin, integritetin dhe profesionalizmin e shërbimeve të kryera nga Autoriteti.

Neni 13

Financimi

1. Autoriteti, për realizimin e funksioneve të parashikuara në këtë ligj, harton buxhetin vjetor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2. Ministri, në përputhje me kushtet për të cilat është rënë dakord në marrëveshjen e shërbimit, për çdo vit financiar, autorizon përdorimin e fondeve të miratuara në Buxhetin e Shtetit për funksionimin e Autoritetit.

Neni 14

Dispozita kalimtare

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, transformohet në Autoritetin Rrugor Shtetëror. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe funksionet e DPRR-së do të vazhdojnë të ushtrohen prej saj, deri në fillimin e veprimtarisë se organeve të Autoritetit.

Neni 15
Dispozita e fundit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në zbatim të pikave 1 dhe 3 të nenit 3, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6312, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi